

# BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E MBROJTJES MIDIS SHQIPËRISË DHE KOSOVËS





# **Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes midis Shqipërisë dhe Kosovës**

Prishtinë dhe Tiranë  
2015

**Botuar nga:**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
[QKSS]  
Sylejman Vokshi, Blloku B, Hyrja 2, Nr. 1  
10000 Prishtinë  
Telefon dhe faks: +381 38 221 420  
Email: info@qkss.org  
Ueb: www.qkss.org

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim  
[IDM]  
Rr. Shenasi Dishnica, Nr. 1, Tirana, Albania  
P.O. Box 8177  
Telefon: +355 4 240 0241  
Faks: +355 4 240 0640  
Email: info@idmalbania.org  
Ueb: www.idmalbania.org

**Autor:**

Foto Duro  
[Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim]

**Redaktor:**

Florian Qehaja  
[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë]

**Dizajni dhe faqosja:**

Marko Marinković

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër  
Bogdani”

355.58(496.5:496.51)

Duro, Foto

Bashkëpunimi në fushë e mbrojtjes midis  
Shqipërisë dhe Kosovës / Foto Duro. –  
Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të  
Sigurisë ; Tiranë : Instituti për Demokraci dhe  
Ndërmjetësim, 2015. – 181 f. : ilustr. ; 30 cm.

Bibliografi : f. 22

ISBN 978-9951-697-26-8

ISBN 978-9951-697-26-8

Prishtinë dhe Tiranë, 2015  
E drejta e autorit © 2015 QKSS dhe IDM

Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të  
riprodhohet, të ruhet në baza të dhënash,  
apo të transmetohet në ndonjë formë  
përmes sistemeve elektronike, mekanike,  
fotokopjimit, incizimit apo në ndonjë mënyrë  
tjetër pa lejen paraprake të botuesve.

Ky botim u realizua në kuadër të projektit “Forumi Hulumtues për Siguri: Beograd-Prishtinë-Tiranë”, i mbështetur nga qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë. Pikëpamjet dhe analizat e paraqitura në këtë botim janë të autorit dhe nuk i përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e qeverisë së Norvegjisë, apo të ndonjë organizate tjetër që ka të bëjë me to.



## **PËRMBAJTJA**

<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>6</b>
<b>ABSTRAKT .....</b>	<b>7</b>
<b>MIRËNJOHJE .....</b>	<b>7</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>8</b>
<b>PJESA I, SEKTORI I MBROJTJES NË KOSOVË – ENDE NË FORMIM .....</b>	<b>9</b>
<b>PJESA II, MARRËDHËNIET SHQIPËRI-KOSOVË NË FUSHËN E MBROJTJES .....</b>	<b>12</b>
<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>21</b>
<b>BIBLIOGRAFI .....</b>	<b>23</b>



## SHKURTESAT

<b>A&amp;S</b>	Arsimim – Stërvitje
<b>BCU</b>	Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak
<b>FAK</b>	Forcat e Armatosura të Kosovës
<b>FASH</b>	Forcat e Armatosura Shqiptare
<b>FSK</b>	Forca e Sigurisë së Kosovës
<b>GjB</b>	Gjeneral Brigadë
<b>KDS</b>	Komanda e Doktrinae dhe Stërvitjes
<b>MFSK</b>	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
<b>MMRSH</b>	Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë
<b>NAT</b>	Ekipi Këshillues i NATO-s
<b>O&amp;M</b>	Operacione dhe Mirëmbajtje
<b>RSSS</b>	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
<b>STANAG</b>	Standardet e NATO-s
<b>UÇK</b>	Ushtria Çlirimtare e Kosovës

## ABSTRAKT

Rrënjët e përbashkëta etnike midis shqiptarëve në Shqipëri e Kosovë, por edhe gatishmëria e hapat e hedhura nga qeveritë përkatëse për bashkëpunim, e favorizojnë këtë bashkëpunim edhe në fushën e mbrojtjes. Bashkëpunimi ushtarak ka nisur qysh në fillimet e viteve 90' dhe është karakterizuar nga tri periudha të veçanta: a) prej 1991 deri në Qershor 1999 (përfundimi i luftës në Kosovë); b) Qershor 1999 – shkurt 2008 (deklarimi i pavarësisë së Kosovës) dhe c) post-2008, kur ky bashkëpunim fillon të zhvillohet normalisht. Në fakt, ende thellësia dhe efektet e këtij bashkëpunimi mbeten larg pritshmërisë. Këtu ka ndikuar një farë shqetësimi (i shprehur apo i nënkuptuar) i ndonjë vendi të rajonit apo komunitetit ndërkombëtar ndaj nismave të Shqipërisë për bashkëpunim me Kosovën, mbivendosjet apo dublikimet në ndihmat e ofruara Kosovës prej një numri vendesh të tjera, por në disa raste edhe pamundësia e Shqipërisë për të dhënë ekspertizën e duhur.

Arsimimi dhe trajnimi ushtarak, si dhe integrimi Euro-Atlantik janë fushat ku bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Kosovë duken më të zhvilluara. Heqja e kufizimeve kushtetuese ndaj sektorit të mbrojtjes në Kosovë, që pritet të ndodhë në të ardhmen e afërt, duke i hapur rrugë ndërtimit të një force të armatosur standarde, hap perspektiva të reja për këtë bashkëpunim. Ai duhet të zhvillohet në gjerësi, por të synojë edhe cilësinë. Sidomos fusha e operacionalitetit duhet të ketë prioritet, pasi ka efekte direkte ndaj sigurisë së përbashkët, i kontribuon frymës së përgjithshme të bashkëpunimit rajonal për sigurisë dhe ka gjithashtu një ndikim mjaft pozitiv tek publiku.

## MIRËNJOHJE

Për realizimin e këtij studimi dhanë një mbështetje të posaçme: Gjeneralbrigade Enver Cikaqi, zotërinjtë Faruk e Sinan Geci, Kolonelët Ilir Qeriqi e Fadil Hadërgjonaj, Nënkolonel Enver Dugolli, zotërinjtë Kosum Kosumi e Hisen Berisha të gjithë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës e bashkë me ta Gjeneralmajor (në pension) Ramadan Qehaja, të cilët patën mirësinë dhe gatishmërinë të më përcjellin njohuritë dhe eksperiencat e tyre për progresin dhe sfidat e sektorit të mbrojtjes në Kosovë. Kolonel (në pension) Dilaver Goxhaj, pedagogu im në Akademinë e Mbrojtjes dhe më pas Zëvendëssof i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK, solli fakte të panjohura për Luftën Çlirimtare në Kosovë, gjatë periudhës 1998-1999. Mbështetja e këtyre miqve ka qenë e pazëvendësueshme, prandaj i falënderoj e u jam shumë mirënjohës për këtë. Gjithashtu falënderoj kolegët e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, me të cilët jetova e punova për dy javë (Mars 2015) veçanërisht Florian Qehajan dhe Sofie Kryeziun, për sugjerimet, inkurajimin dhe koordinimin e gjithë takimeve për intervistat e zhvilluara për këtë studim.

## HYRJE

Megjithëse të ndarë politikisht e fizikisht për gati një shekull, shqiptarët e Shqipërisë e të Kosovës (sikurse ata që popullojnë trevat e Serbisë Jug-Lindore, Maqedonisë e Malit të Zi) nuk e humbën kurrë ndjenjën e përkatësisë së përbashkët kombëtare.<sup>1</sup> Historikisht, është një komb i ndarë dhunshëm një shekull më parë.<sup>2</sup> Gjuha shqipe flitet në tërë këto rajone me disa nuanca dialektore, ndërsa një numër vlerash të përbashkëta etno-kulturore kanë garantuar lidhje të fuqishme në një numër rastesh. Kështu, gjatë krizës së Kosovës të vitit 1999, mbi 500,000 kosovarë u akomoduan në Shqipëri, shumica në familjet shqiptare.<sup>3</sup> Është kjo ndjenjë identiteti kombëtar që natyrshëm rrit efektin e kontributeve të Shqipërisë në konsolidimin e kapaciteteve të institucioneve kosovare. Nga ana tjetër ekziston një gatishmëri e demonstruar qartë tashmë midis qeverive përkatëse për bashkëpunim, deri në takime të përbashkëta të tyre.<sup>4</sup> Shqipëria ka interes të natyrshëm për një Kosovë të fortë e të sigurt edhe për faktin se me të ajo ndan kufi dhe objektiva të përbashkëta për siguri e prosperitet, me efekt pozitiv edhe për rajonin.

Këto premisa të favorshme krijojnë përshtypjen se bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë në fushën e mbrojtjes është zhvilluar mirë. Studimi sjell një përgjigje realiste për këtë pasi analizon: Sa është institucionalizuar ky bashkëpunim? Sa i qëndrueshëm dhe përfshirës (nga pikëpamja e kohës dhe fushave) paraqitet ai? Cilat janë disa nga arritjet dhe mangësitë e këtij bashkëpunimi dhe ç'mund të bëhet më mirë në të ardhmen?

1 Për më shumë shih: Vickers, "The role of Albania in the Balkan region" *Chaillot Paper*, No107, p.11-27

2 Vendosur në Konferencën e Ambasadorëve, Londër [fund 1912 - mesi 1913] menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe disfatës së Perandorisë Otomane në Luftërat Ballkanike (1912-1914).

3 Numri i kosovarëve të shpërngulur e akomoduar në Shqipëri në atë kohë përbënte rreth 20% të popullsisë së Shqipërisë. Në disa qytete shqiptare (si Kukësi) popullsia, gati u trefishua.

4 Deri tani janë zhvilluar dy takime të tilla, në Kosovë dhe Shqipëri (përkatësisht në Janar 2014 dhe Mars 2015) ku janë nënshkruar disa marrëveshje që mbulojnë gati të gjitha fushat e funksioneve të shtetit.

Për studimin është përdorur një kombinim i metodave cilësore e sasiore. Marrëveshjet në fushën e mbrojtjes, të nënshkruara midis dy vendeve, raportet vjetore të Ministrisë së Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK) Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) të Republikës së Kosovës (2012-2014) së bashku me 12 intervista (të gjysmë-strukturuara) të realizuara gjatë Shkurt-Marsit 2015 me persona të informuar, pjesëtarë (aktualisht apo në të shkuarën) të sektorit të mbrojtjes të Kosovës apo Shqipërisë, kanë qenë burime të rëndësishme informacioni. Përveç përvojës personale të autorit (për shkak të pozicioneve të mbajtura për rreth një dekadë në Shtabin e Përgjithshëm apo Mistrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë) një numër studimesh të realizuara kryesisht nga hulumtues kosovarë kanë qenë gjithashtu me vlerë për analiza cilësore e konkluzione në lidhje me objektivat dhe tendencat e zhvillimit të institucioneve të mbrojtjes në Kosovë, së bashku me mësimet e nxjerra për reformimin e mëtejshëm të tyre në Shqipëri e Kosovë. Një numër botimesh me objekt periudhën para pavarësisë së Kosovës kanë qenë shumë të rëndësishme për shqyrtimin e marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë në të shkuarën (në plan të përgjithshëm dhe atë të mbrojtjes). Së fundi, për një kuptim më të mirë të këtij bashkëpunimi, në studim janë bërë disa krahasime sasiore me partnerë të tjerë të FSK, të shoqëruara me konkluzionet përkatëse.

Studimi përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë trajton veçoritë e institucioneve politike, të sigurisë e të mbrojtjes në Kosovë. Pas një analize më në thellësi të çështjeve të mbrojtjes në Kosovë, sidomos aspekteve ligjore, konceptuale dhe strukturore, në studim jepen disa konkluzione mbi tipin e mbrojtjes që është më e përshtatshme për kushtet e Kosovës. Pjesa e dytë fokusohet në çështjet e bashkëpunimit ushtarak Shqipëri-Kosovë. Në të analizohet niveli i këtij bashkëpunimi deri tani, aspektet pozitive, si dhe drejtimit e mënyrat për përmirësim të mëtejshëm. Studimi mbyllet me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse për një bashkëpunim më efektiv midis Shqipërisë e Kosovës në fushën e mbrojtjes.



## PJESA I, SEKTORI I MBROJTJES NË KOSOVË – ENDE NË FORMIM

### 1. Siguria në Ballkan

Pavarësisht një farë euforie në dokumentet e sigurisë të gjithë vendeve të rajonit, aktualisht siguria në Ballkan mbetet e brishtë. *“Misioni i ndërtimit të paqes në Ballkan nuk ka përfunduar ende [...]. Vetëm kur gjithë vendet e rajonit do të jenë në mënyrë të pakthyeshme në kursin drejt BE, do të mund të festojmë. [...] Deri atëherë, ne duhet të mbajmë Ballkanin në linjë, duke siguruar që Bosnja, Kosova dhe Maqedonia qëndrojnë në tren”*.<sup>5</sup> Këto vlerësime përputhen edhe me perceptimin e popullsisë të rajonit. Në 2014, WIN Gallup International kreu një sondazh në 64 vende të Botës në lidhje me gatishmërinë e popujve për mbrojtjen e vendeve të veta. Sipas tij, qytetarët e Kosovës ishin më të gatshmit për mbrojtjen e vendit me 58% të të intervistuarve.<sup>6</sup> Bazuar në këtë sondazh, rreth 45% e ballkanasve ishin gati të shkonin në luftë, kundrejt 25% të qytetarëve të vendeve të tjera të Europës Perëndimore, provë kjo e një ndjenje konstante e më të lartë alarmi dhe militantizmi në Ballkan, krahasuar me pjesën tjetër të Europës. Nga ana tjetër, sipas Xhon Kerrit, Sekretarit Amerikan të Shtetit, një numër vendesh ballkanike, përfshi Kosovën, janë *“në linjën e zjarrit”*, për shkak të përpjekjeve të Rusisë për të rindezur *“një lojë të re, ose-humbje-ose-fitore, që është e rrezikshme dhe e panevojshme”*.<sup>7</sup>

Një numër sondazhesh të kryera së fundi në Kosovë, në lidhje me perceptimin e publikut për sigurinë, zbulojnë që shumica e qytetarëve kosovarë kanë pasiguri e mosbesim, sidomos ndaj Serbisë. Kështu në sondazhin e kryer nga Qendra e Kosovës për Stu-

dime për Sigurinë [QKSS] në Tetor 2013, 64% e të intervistuarve e konsideronin sigurinë kombëtare të Kosovës “të kërcënuar”, ndërsa 16% e tyre e konsideronin nivelin e rrezikut “shumë të lartë”. Mbi 69% e kosovarëve e konsideronin Serbinë një “vend armiqësor”.<sup>8</sup> Një përqindje relativisht e lartë e popullsisë në Kosovë, sipas këtij sondazhi, beson se një konflikt i armatosur është i mundshëm në rajon, në të ardhmen e afërt.<sup>9</sup> Sidoqoftë, në sajë të prezencës së trupave të NATO-s në Kosovë, një agresioni ushtarak ndaj Kosovës, për momentin konsiderohet pak i mundshëm.<sup>10</sup>

Përveç shqetësimeve për sigurinë, nevoja e konsolidimit të sektorit të mbrojtjes në Kosovë nxitet edhe nga konsiderata të tjera politike. Forcat e armatosura konsiderohen si një tregues i qenësishëm i një shteti normal. Me fare pak përjashtime (në Europë vetëm Islanda, përveç Kosovës) vendet investojnë pjesë të rëndësishme të burimeve të tyre njerëzore, materiale e financiare për të ngritur e mbajtur ushtritë e veta në standardet e kohës. Në shoqërinë Kosovare ka një interes të madh për çdo hap shtetformues. Sidomos çështja e forcave të armatosura ka qenë kaq e ndjeshme, veçanërisht gjatë procesit të RSSS [2012-2014] sa që, në një farë mase, ka eklipsuar çështjet e tjera të reformës në Sektorin e Sigurisë.<sup>11</sup>

### 2. Sistemi i mbrojtjes në Kosovë

Rritja që konstatohet sot në nivelin e papara-shikueshmërisë së kërcënimeve ndaj sigurisë, por edhe larmia e mjeteve dhe metodave të luftimit, qofshin ato konvencionale aëp asimetrike, kanë prodhuar gjithashtu një larmi definicionesh për luftën moderne. Pavarësisht nga kjo, në përgjithësi pranohet që një ushtri moderne, para së gjithash, duhet të jetë në gjendje të zhvillojë operacione në

5 Petersen dhe Server, “The Balkans Can Still Be Lost”, 2010.

6 Për më shumë, shih: [http://www.wingia.com/en/services/end\\_of\\_year\\_survey\\_2014/regional\\_results/8/46/](http://www.wingia.com/en/services/end_of_year_survey_2014/regional_results/8/46/)

7 John Kerry, deklarim përpara nënkomisjonit të Senatit, Shkurt 2015, tek: [http://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2015&mm=02&dd=25&nav\\_id=93293](http://www.worldreview.info/content/kosovo-russia-s-sights-ukraine-style-conflict-gjithashtu_tek: http://www.b92.net/eng/news/world.php?yyyy=2015&mm=02&dd=25&nav_id=93293)

8 Kosovo Barometer, Dec.2013, f.6

9 Po aty, f.8

10 Muja A, “What next for the KSF, an army or not?” 2013, f.8-9

11 Për më shumë shih: Qehaja F, “The Development Context of the Strategic Security Sector Review”, 2013.

“tre dimensione” të fushës së luftimit: gjerësi (front) thellësi dhe në dimensionin vertikal.

Duke mos llogaritur KFOR (mision mbrojtës i ndërmarrë nga NATO) aktualisht Kosovës i mungon një sistem “[...] për të mbrojtur territorin e vet, hapësirën ajrore, [...] infrastrukturën kritike dhe interesat e veta kombëtare”<sup>12</sup>. FSK konsiderohet një forcë “pothuajse ushtarake”, por për shkak të kufizimeve të komunitetit ndërkombëtar, ajo e ka të pamundur të zhvillojë operacione luftarake moderne në asnjë nga dimensionet e sipërpërmendura. “Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, i njohur gjerësisht si “Plani Ahtisaari” përcakton: “PNU [Prezenca Ndërkombëtare Ushtarake] do të jetë përgjegjëse për sigurinë në gjithë territorin e Kosovës [...] derisa [...] institucionet e Kosovës të jenë në gjendje ta marrin përsipër këtë përgjegjësi [...]”<sup>13</sup>. Në lidhje me institucionet mbrojtëse, Plani Ahtisaari përcakton: “FSK duhet të armatoset lehtë dhe të mos posedojë armë të rënda si tanke, artileri të rëndë apo kapacitete sulmuese ajrore. FSK do të konsistojë në jo më shumë se 2,500 trupa aktive dhe 800 rezerviste”<sup>14</sup>. “[FSK] do të jetë përgjegjëse kryesisht për reagim ndaj krizave, çaktivizim të eksplozivave dhe mbrojtje civile”<sup>15</sup>. Pavarësisht nga kjo, struktura hierarkike e FSK është tërësisht e mbështetur në modelet e NATO-s. Procesi i saj i rekrutimit, trajnimit dhe krijimit të kapaciteteve mbikëqyrret nga NATO dhe bazohet në të njëjtat standarde që aplikohen në ushtritë e vendeve demokratike.<sup>16</sup>

Duke qenë se kufizimet ishin për një periudhë 5-vjeçare (që përfundoi në Qershor 2012<sup>17</sup>) Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë (RSSS) i finalizuar në Mars 2014, rekomandoi krijimin e Forcës së Armatosur të Kosovës (FAK) si “[...] forcë e armatosur kombëtare [...] e paji-

sur për të kryer misione mbrojtëse, e autorizuar të shërbejë brenda vendit dhe të dislokohej jashtë vendit, në mbështetje të operacioneve të paqes [...] një forcë profesioniste [...] e ndërtuar sipas standardeve të NATO-s”<sup>18</sup>. Referuar karakteristikave të luftës moderne, të përmendura më lart, duke mbajtur parasysh burimet e kufizuara të një shteti të vogël e të porsakrijuar si Kosova, do të ishte e këshillueshme që FAK të ndërtohej e zhvillonte kapacitete që do t’i mundësonin kryerjen e operacioneve luftarake të paktën në dy dimensione (gjerësi, thellësi) ndërsa për dimensionin e tretë, atë vertikal, të mund të zotëronte kapacitete të arsyeshme për mbrojtjen nga ajri. Një sondazh i zhvilluar në 2011 me personel kompetent nga MFSK dhe FSK, si dhe një numër të kufizuar parlamentarësh kosovarë, dha informacion të dobishëm në lidhje me pajisjet luftarake që konsiderohen të arsyeshme e të nevojshme për misionet e ardhshme të FAK. Në mënyrë realiste u sugjeruan mjete luftarake të blinduara lehtë, helikopterë transporti, artileri e lehtë dhe mbrojtje kundërajrore.<sup>19</sup>

Shtjellimi i mëtejshëm në këtë studim është bërë me supozimin që një ditë, në një të ardhme të afërt, FSK do të evoluojë në forcë reale të armatosur e konvencionale, e ngjashme me ushtritë e tjera të rajonit.

### 3. Programi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë

Përfundimi formal i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (Shtator 2012) u konsiderua si “moment i përshtatshëm për të hedhur bazat e mbrojtjes të vendit nga vetë Shteti i Kosovës, në mënyrë realiste, të përbalueshme e tërësore”<sup>20</sup>. Në Prill 2012 Qeveria e Kosovës shpalli një program të ri të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë (RSSS)<sup>21</sup>, me objektiv vlerësimin e mjedisit

12 Winkler, “The reform and democratic control of the security sector and international order”, DCAF, 2002, f.10

13 Plani Ahtisaari, 2007, Neni 14.4, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 126.

14 Po aty, Aneks 8, Neni 5.2

15 Po aty, Aneks 8, Neni 5.4

16 Vrajolli dhe Kallaba, “Kosovo path towards the NATO PfP Program”, 2012, f. 16

17 Plani Ahtisaari, 2007, Aneks 8, Neni 5.3

18 Analiza e RSSS, Prishtinë, 2014, f. 30

19 Për më shumë shih: Geci S. “Kosovo Security Force, Post 2012”, 2011, p.35-38.

20 Analiza e RSSS, f. 7

21 RSSS është e dyta e kësaj natyre, pas asaj të zhvilluar në 2006 (pjesë e Programit të Zhvillimit të OKB).

strategjik të sigurisë, identifikimin e kërcënimeve dhe rekomandimin e masave për t'u përballur me to. RSSS konstatoi që tashmë "rajoni konsiston në vende anëtare të NATO-s dhe vende që aspirojnë për anëtarësim në NATO apo BE. [...] Rreziku për luftë konvencionale shteti-kundër-shtetit është zvogëluar ndjeshëm [ndërsa] kërcënimet, rreziqet dhe sfidat që mund të cenojnë sigurinë e Kosovës burojnë më shumë nga pabarazia ekonomike, aktivitetet terroriste, armët e dëmimit në masë, përhapja e armëve të lehta, krimi i organizuar [përfshi trafiqet] dhe krimi kibernetik".<sup>22</sup> Në mjedisin kompleks të sigurisë rajonale, duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara të Kosovës, RSSS vlerësoi si rrugën më të mirë për forcimin e sigurisë kombëtare "një politikë bashkëpunimi me NATO e BE për mbrojtjen dhe sigurinë, por edhe nëpërmjet iniciativave rajonale"<sup>23</sup>. Nga ana tjetër, RSSS rekomandoi "kalimin e FSK në Forcën e Armatosur të Kosovës, me mision mbrojtjen e integritetit territorial të vendit, mbështetjen e autoriteteve civile në situata katastrofash dhe pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare të paqes"<sup>24</sup>. FAK do të përbëhej nga "maksimumi 5,000 trupa aktive dhe 3,000 rezerviste"<sup>25</sup>.

Duke marrë në konsideratë prezencën e KFOR, nivelin jo të lartë të rrezikut dhe rezervat e kufizuara të Kosovës, RSSS rekomandoi një formim gradual të FAK, në tre faza: Faza I [2014-2016] – krijimi "i bazave të nevojshme kushtetuese, ligjore, doktrimore dhe konceptuale [...] i profesionalizmit dhe institucioneve [si dhe marrja e vendimeve për] materialet që do të prokurohen"<sup>26</sup>. Faza II [2017-2019] – përsosja e Komandim – Kontroll – Komunikimit dhe fillimi i prokurimit për pajisjet kryesore individuale e kolektive, ndërkohë FAK do të arrijë kapacitetin operacional fillestar. Faza III [2020-2024] – finalizimi i "Planit Afatgjatë të Zhvillimit". FAK arrin kapacitetin e plotë operacional.<sup>27</sup>

22 Analiza e RSSS, f.15-16

23 Po aty, f. 27

24 Po aty, f. 5

25 Po aty, f. 31

26 Po aty.

27 Po aty

Sikundër pritej, rekomandimet e RSSS për krijimin e FAK shkaktuan reagim të ashpër nga Serbia. FAK u konsiderua "absolutisht e papranueshme [...] [e destinuar] për t'u përdorur kundër serbëve [...] mundësi për konflikt inter-etnik"<sup>28</sup>. Krejt ndryshe, për një numër analistësh nga shoqëria civile në Serbi "Transformimi i FSK në një forcë të armatosur nuk përfaqëson një kërcënim sigurie për Serbinë, serbët në Kosovë, apo për rajonin".<sup>29</sup>

RSSS pati një numër aspektesh pozitive. Ky proces, për të parën herë u mor plotësisht përsipër nga institucionet e Kosovës. Gjithashtu pozitiv ishte niveli i përfshirjes (përtej institucioneve tradicionale të sigurisë) dhe transparencës. Lidhshipi politik i Kosovës zgjodhi opsionin e një ushtrie të vogël, të paracaktuar për misione mbrojtëse e humanitare. Përveç sa më sipër, me propozimet konkret për sektorin e mbrojtjes, partneriteti i synuar i Kosovës me NATO-n, sikurse marrëdhëniet aktuale të saj me ministrinë e mbrojtjes dhe forcat e armatosura të një numri vendesh të rajonit (përfshi Shqipërinë) do të marrin gradualisht simetrinë normale "forcë e armatosur ndaj forcës së armatosur". Nga ana tjetër, procesi i RSSS u ndesh me një numër sfidash dhe vështirësish. Veçanërisht, ai nuk mundi t'i shmangej varësisë nga agjendat politike kombëtare e rajonale, e reflektuar kjo në mënyrën e formulimit për një numër problemesh dhe gjithashtu vonesat nga afatet e paracaktuara<sup>30</sup>. Përveç kësaj, çështja e krijimit të Forcës së Armatosur dominoi procesin e RSSS, diskursin politik e mediatik dhe interesimin e publikut, duke eklipsuar çështjet dhe institucionet e tjera të sigurisë.<sup>31</sup>

28 [http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2014&mm=03&dd=14&nav\\_id=89649](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2014&mm=03&dd=14&nav_id=89649)

29 Stacic, tek: [http://www.avim.org.tr/bulten\\_print/en/87342](http://www.avim.org.tr/bulten_print/en/87342)

30 Sidomos vendimtar këtu është kushti që krijimi i FAK duhet të paraprihet nga ndryshimet kushtetuese, të cilat mund të bëhen vetëm me miratimin e të paktën 2/3 të anëtarëve të Parlamentit dhe 2/3 të anëtarëve prej minoriteteve (Plani Ahtisaari, Neni 10.1, Kushtetuta e Republikës Kosovës, Neni 144/2).

31 Welch A, 2014, <http://www.ssrresourcecentre.org/2014/06/19/kosovos-home-grown-ssr-the-strategic-security-sector-review-part-two/>

## PJESA II, MARRËDHËNIET SHQIPËRI-KOSOVË NË FUSHËN E MBROJTJES

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë ka qenë i pamundur për shkak të marrëdhënieve problematike midis tyre. Ca më pak mund të imagjinohej ky bashkëpunim me Kosovën. Konfliktet e përgjakshme të fillim viteve 1990' në Jugosllavi, nuk mund të kursenin as Kosovën. Natyrshëm në një situatë të tillë, Shqipëria konsiderohej si mbështetësi i parë dhe kryesor për Kosovën, politikisht dhe ushtarakisht. Në fakt, raportet Shqipëri-Kosovë gjatë kësaj periudhe mbetën të komplikuar e të pazhviluara, të paktën deri në Mars 1999, kur filloi fushata ajrore e NATO-s kundër Serbisë.

### 1. Zhvillimi në kohë i marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë në fushën e mbrojtjes

Marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë në fushën e mbrojtjes kanë njohur tri faza të dallueshme: 1990 - 1999; 1999-2008 dhe nga 2008 e në vijim.

#### Faza I (1990-1999):

Në këtë periudhë, mund të përmendet rasti [jo plotësisht i konfirmuar] i përgatitjes ushtarake të një grupi prej 35 kosovarësh, bazuar në një marrëveshje [të pa zyrtarizuar] midis udhëheqësit Shqiptar të asaj kohe, Ramiz Alia dhe Kryeministrit të Qeverisë Kosovare në mërgim, Bujar Bukoshi. Pjesëtarët e grupit u zgjodhën kryesisht nga diaspora kosovare. Trajnimi u krye për 6 javë dhe i kushtohej kryesisht njohjes dhe përdorimit të armëve të lehta, si dhe disa njohurive bazë të lidshimit. Pas përfundimit të këtij trajnimi vetëm 5 persona u kthyen në Kosovë, ndërsa e gjithë ndërmarrja nuk pati ndonjë efekt për Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës<sup>32</sup>.

Gjatë periudhës 1992-1997, “[...] çdo diskurs dhe veprim në Tiranë në lidhje me Kosovën ishte kufizuar në fushën diplomatike, ndërsa aksionet ushtarake të shqiptarëve të Kosovës, kundër okupimit serb, përjashtoheshin”<sup>33</sup>. Për më tepër, Qeveria Shqiptare atë kohë ishte vënë nën presion, sidomos nga Qeveria Britanike, për të mbyllur kampet e trajnimit, që supozohej se ishin hapur në Shqipëri dhe për të arrestuar personelin e UÇK. “Mund të provohet se Qeveria [Shqiptare] e tradhtoi kombin duke iu nënshtruar këtij presioni dhe duke vepruar kundër UÇK që po lindte”<sup>34</sup>. Janë disa drejtues të UÇK që u arrestuan në Tiranë midis 1993 e 1997, përfshi Adem Jasharin, themeluesin e UÇK, Ashim Thaçin, zëdhënësin politik të saj, Zahir Pajazitit, drejtuesin e Grupit të Llapit, etj<sup>35</sup>. Anarkia dhe kaosi i vitit 1997 në Shqipëri<sup>36</sup>, krijoi një mundësi relativisht të mirë për luftëtarët e UÇK për të përdorur territorin e Shqipërisë Veriore e Verilindore si bazë për aksionet e tyre, ndërsa “autoritetet e Shqipërisë bënë syrin e verbër për aktivitetet e kryengritësve kosovarë në Shqipëri”<sup>37</sup>. Shqipëria siguroi bazim operacional dhe logjistik për trupat e NATO-s në fushatën e tyre kundër Serbisë [1999] dhe asistencë humanitare për refugjatët shqiptarë të Kosovës. Ndërkohë, ndaj UÇK, përveç mbështetjes politike, mbështetja direkte ushtarake nga Qeveria Shqiptare ka qenë minimale ose ka munguar plotësisht. Krejt ndryshe ka qenë kontributi vullnetar që një pjesë e popullsisë së Shqipërisë dha për UÇK dhe Lëvizjen Çlirimtare të Kosovës në këtë periudhë. Rreth 200 luftëtarë kosovarë, të organizuar në grupe prej 8-10 vullnetarësh u stërvitën nga mesi i vitit 1998 deri Shkurt 1999 nga Major Adem Shehu, në rajone të veçuara, brenda Shqipërisë. Më vonë, në Shkurt 1999, ai vet iu bashkua UÇK duke marrë edhe detyrën e Komandantit të Brigadës 153të të UÇK.<sup>38</sup> Në pranverën e 1999, ishin 148 vullnetarë nga

33 Pettiffer dhe Vickers, “The Albanian question”, 2009, f.96

34 Po aty, f.98

35 Po aty.

36 Shkaktuar nga zemërimi i popullsisë për shkak të humbjes së kursimeve në skemat piramidale.

37 Vickers, “The Albanians”, London, 1999, f.254

38 Polovina, “Një kolonel midis Tiranës dhe Prishtinës”, 2007, f.106-107.

32 Intervistë me Kolonel [në pension] Dilaver Goxhaj.

Shqipëria që luftonin në radhët e UÇK. Njëri prej tyre, Kolonel (në pension) Dilaver Goxhaj, arriti deri pozicionin e Zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK. 30 anëtarë të UÇK, nga Shqipëria, dhanë jetën në këtë luftë.<sup>39</sup>

### Faza II (1999-2008):

Në Qershor 1999 trupat e NATO-s u dislokuan në Kosovë. Forcat serbe të sigurisë dhe mbrojtjes u tërhoqën përtej kufirit administrativ Serbi-Kosovë, ndërsa institucionet administrative serbe ndërprejnë ushtrimin e çdo funksioni në territorin e Kosovës. Misioni i përkohshëm administrativ i OKB (UNMIK) u vendos në Kosovë “me autoritet ndaj territorit dhe popullsisë së Kosovës, përfshirë gjithë fuqitë ligjore e ekzekutive, administrimin dhe gjykatat”<sup>40</sup>. Shqipëria nisi mbështetjen për ndërtimin e kapaciteteve qeverisëse të Kosovës, në disa fusha. Bashkëpunimi përfshiu gjithashtu sektorin e sigurisë, fillimisht me UNMIK, ndërsa më vonë me institucionet kosovare të sigurisë që po lindnin, e lidhur kjo kryesisht me policinë dhe kontrollin e kufirit. Për sa i përket mbrojtjes, përveç mbështetjes ndaj KFOR [kryesisht me vënien në dispozicion të porteve detare e ajrore të Shqipërisë] Shqipëria nuk ofroi pothuajse asgjë ndaj Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK)<sup>41</sup>. Prezenca e KFOR (në fillimet e tij prej rreth 50,000 trupash) ishte një garanci për Kosovën, ndaj kërcënimeve të jashtme. Nga ana tjetër, për shkak të sensitivitetit politik në ato momente, UNMIK dhe NATO, në mënyrë indirekte, por të vendosur, u pozicionuan kundër çdo nisme të Shqipërisë për Kosovën në fushën e mbrojtjes. Si rezultat, i vetmi aktivitet bashkëpunimi në këtë periudhë është ndjekja (në 2002) e Kursit të Lartë të Sigurisë në Tiranë prej dy civilëve nga Kosova.<sup>42</sup>

### Faza III (pas vitit 2008):

Deklarimi i pavarësisë së Kosovës në Shkurt 2008 që u pasua me njohjen e Republikës së Kosovës nga ShBA dhe shumë vende të tjera (përfshi Shqipërinë) shtroi rrugën për një bashkëpunim real e institucional në fushën e mbrojtjes midis Shqipërisë dhe Kosovës. Ka një numër marrëveshjesh të nënshkruara në këtë periudhë, midis dy vendeve, në fushën e mbrojtjes. Ato filluan me “Memorandumin e mirëkuptimit” [2010] për të vijuar me marrëveshjet “Për Statusin e Forcave – SOFA” [2013]; “Për integrimin Euro-Atlantik” [2014] dhe “Për Arsimimin e trajnimin ushtarak” [2014].

Në mënyrë permanente, Serbia ka qenë vigjilente, ndërsa protestat e saj kanë ndjekur çdo përçarje bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë në fushën e mbrojtjes. Në këtë aspekt, një shembull domethënës ishte reagimi i qarqeve politike, mediave dhe opinionit publik serb në lidhje me marrëveshjen SOFA<sup>43</sup>, të nënshkruar midis Shqipërisë dhe Kosovës në Korrik 2013. Megjithëse e formuluar sipas formatit të NATO-s, ajo u interpretua si një hap drejt “Shqipërisë së Madhe”. Në lidhje me të, Zëvendëskryeministri i asaj kohe, Vuçiç, lëshoi një deklaratë të fortë kundër Qeverisë Shqiptare.<sup>44</sup> Për shkak të këtij sensitiviteti, ka pasur përherë një hezitim të dukshëm nga komuniteti ndërkombëtar në Kosovë për të pranuar ofertat e Qeverisë Shqiptare, sidomos në fushën e mbrojtjes. Pavarësisht nga kjo, bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Kosovë ka përparuar, duke përfshirë gati gjithë spektrin, por siç do të shtjellohet më tej, cilësia dhe efekti i këtij bashkëpunimi, të paktën deri tani, ka qenë nën nivelin e pritshëm.

39 Intervistë me Kolonel (Pension) Dilaver Goxhaj.

40 <http://www.un.org/en/peacekeeping/missions/unmik/background.shtml>

41 TMK, ishte vazhduesja e UÇK (fundi i 1999 - Qershor 2008, kur u zëvendësua nga FSK).

42 Intervistë me person të informuar në KDS të FASH.

43 Marrëveshje për mënyrën e sjelljes të trupave të njërit vend gjatë kohës së qëndrimit në vendin tjetër

44 Për më shumë shih: [http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/features/2013/07/11/feature-01](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/07/11/feature-01).

## 2. Fushat e bashkëpunimit ushtarak

Drejtuesit kryesorë të FSK u emëruan që në 2008 (Ministri në Qershor dhe Komandanti në Dhjetor) ndërsa betimi i 106 rekrutëve të parë u bë në Qershor 2009.<sup>45</sup> Marrëveshja e parë e bashkëpunimit midis Ministrisë së Mbrojtjes (MM) të RSH dhe Ministrisë së FSK (MFSK) e nënshkruar në Shkurt 2010 mbulonte: politikat e sigurisë dhe doktrinat; arsimim-stërvitjen; legjislacionin; shkëmbimin e informacionit; marrëdhëniet me publikun; shkëmbimet kulturore e sportive, etj.<sup>46</sup> Për koordinimin e këtij bashkëpunimi, në secilën nga ministritë, u krijua grupi drejtues nën kryesimin e zëvendësministrave përkatës.<sup>47</sup> Në fakt, bashkëpunimi kishte nisur më herët nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, më i spikatur në Janar 2010, kur dy skuadra të FSK (16 veta) me pajisjet përkatëse (4 motobarka, automjete, etj) u dërguan në Shqipëri, për të ndihmuar në menaxhimin e përmytjeve në zonën e Shkodrës.

Si një shtet i ri, Kosovës i duhej të përballëj me një numër sfidash për vendosjen e funksioneve bazë të shtetit. Në këtë kontekst, qysh nga pavarësia de-fakto në 1999, Kosova përfitoi asistencë prej vendeve të ndryshme, në disa fusha, përfshi sektorin e sigurisë. Nga ana tjetër, procesi i ndërtimit të kapaciteteve qeverisëse, e pati të pamundur shmangien e dublikimeve dhe fragmentarizmit. Për këtë arsye Agim Çeku, në atë kohë Ministër i FSK dhe kryetar i Komitetit Drejtues për RSSS, ka konstatuar: *“Ne kemi një histori të ndërtimit të institucioneve të sigurisë, në mënyrë paralele me mentorë të ndryshëm [...] Tani Kosova po merr gradualisht vetë në dorë këto procese [...] Ne duhet të eliminojmë dublikimet e kapaciteteve dhe të vetëkoordinohemi [...] duke ndërtuar kështu një orkestër që prod-*

*hon muzikë dhe jo zhurmë”*<sup>48</sup>. Ngjashëm, MFSK dhe FSK kanë bashkëpunim me një numër institucioneve homologe që jo rrallë mbivendosen e publikojnë njëra-tjetrën. Për shkak të burimeve të kufizuara, mbështetja e Shqipërisë për Kosovën nuk mund të jetë e krahasueshme me atë të disa vendeve të tjera. Megjithatë, sikurse u përmend më lart, gjuha e njëjtë dhe njohja më e mirë e situatës, mund ta bëjnë bashkëpunimin ushtarak Shqipëri-Kosovë, më efektiv në disa aspekte.

### 2.1. Integrimi Euro-Atlantik

Kosova është e vendosur të krijojë e mbajë marrëdhënie miqësore me fqinjët dhe të bëhet pjesë në struktura më të gjera sigurie. Sidomos aspirata për integrim në NATO është shprehur qartë në të gjitha dokumentet e saj të sigurisë.<sup>49</sup> Shumica e popullsisë (mbi 88%) gjithashtu mbështet fuqishëm këtë integrim.<sup>50</sup> Pavarësisht nga kjo, me gjithë rolin aktiv të NATO-s në ngritjen e institucioneve të sigurisë në Kosovë dhe konsolidimin në rritje të këtyre të fundit (sidomos FSK) procesi i pranimit të Kosovës në programin e Partneritetit për Paqe (PfP) ende nuk ka nisur.<sup>51</sup> Anëtarësimi në NATO është një proces politik (si për vendin aspirant ashtu dhe për vetë NATO-n) por tradicionalisht, komponenti i mbrojtjes në këtë proces ka qenë një nga më kryesorët. Si i tillë, një marrëveshje e veçantë u nënshkrua në 2014, midis Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë (MMRSH) dhe MFSK *“Mbi bashkëpunimin dhe ndihmën në fushën e integrimit Euro-Atlantik dhe rajonal”*<sup>52</sup>. Bazuar në të, deri tani janë zhvilluar një numër aktiviteteve me synim familjarizimin e FSK e lidhshpimit të MFSK me NATO-n dhe mënyrën si ajo funksionon. Një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit në këtë fushë është mbështetja dhe lobingu

45 <http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Broshura%20ANGLISHT%20-%20-%20finale%207.02.2011.PDF>, pg.8

46 Intervistë me atashetë e mbrojtjes të Shqipërisë dhe Kosovës.

47 Intervistë me atashetë e mbrojtjes të Shqipërisë dhe Kosovës.

48 Welch, 2014, at: <http://www.ssrresourcecentre.org/2014/06/18/kosovos-home-grown-ssr-the-strategic-security-sector-review-part-one/>

49 Vrajolli and Kallaba, “Kosovo path towards the NATO PfP Program”, 2012, p.13

50 Avdia, “Kosovo’s alternatives towards NATO Membership”, 2015, p.25.

51 Për arsye se 4 vende të NATO-s nuk e kanë njohur ende Republikën e Kosovës.

52 <http://www.ata.gov.al/shqiperi-kosove-protokolle-bashkepunimi-ne-fushen-e-mbrojtjes-144442.html>

i Shqipërisë për objektivat Euro-Atlantike të Kosovës, në çdo rast të mundshëm, në takimet në NATO, apo mbi baza bilaterale (me anëtarë të tjerë të NATO-s). Nga ana tjetër, për çdo dokument të dërguar nga Serbia në NATO, në kuadrin e PfP, Shqipëria ka qenë shumë e ndjeshme dhe ka paraqitur vërejtjet e veta për formulimet e palës serbe që janë konsideruar kundërvënëse ndaj statusit të Kosovës së pavarur.<sup>53</sup> Disa deklarime zyrtare nga Serbia pretendojnë se Shqipëria ka bllokuar deri miratimin e këtyre dokumenteve nga NATO, për shkak të formulimeve me referencë Kosovën.<sup>54</sup>

Adoptimi i standardeve të NATO-s (STANAG-ëve) është një kërkesë e pashmangshme për çdo vend që synon partneritetin apo anëtarësimin në NATO. Si të tilla, ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të përpjekjeve të Kosovës drejt integritit Euro-Atlantik. Për të kuptuar dimensionet e kësaj përpjekje, mjafton të mbahet parasysh se vetëm numri i STANAG-ëve të hapur për publikun arrin në rreth 1,300, të organizuar në disa kategori (administrative, operacionale, logjistike, etj). Adoptimi i çdo STANAG-u (i plotë, i pjesshëm, etj) kërkon përpjekje dhe burime (financiare, njerëzore, etj). Deri edhe vetë të kuptuarit në tërësinë e tij të këtij procesi përbën një sfidë për çdo partner të ri të NATO-s. Deri tani, falë edhe bashkëpunimit me ekspertët e Qendrës së Studimeve Strategjike të FASH, ka një progres të dukshëm në aspektin e metodologjisë dhe institucionalizimit të këtij procesi në FSK. Për të janë nxjerrë urdhri i Ministrit të FSK e Rregullorja përkatëse, si dhe është ngritur e funksionon Bordi Drejtues i kryesuar nga Shefi i Departamentit të Operacioneve në MFSK<sup>55</sup>. Në Janar 2015 filloi procesi i adoptimit të STANAG-ëve në bazë të një plani që parashikon adoptimin e dokumenteve “capstone” dhe “keystone”, një fillim i mbarë ky, ecuria e

mëtejshme e të cilit mbetet të shihet në të ardhmen.

## 2.2. Zhvillimi i Koncepteve

Në çdo ndryshim rrënjësor, zakonisht janë konceptet që udhëheqin e ndriçojnë rrugën. Si të tilla, ato konsiderohen shpesh si “themeli” në çdo ndërmarrje të rëndësishme. Zhvillimi i koncepteve mbrojtëse në Kosovë është “hequr zvarrë” për shkak të kufizimeve të vendosura nga Plani Ahtisaari në lidhje me misionin dhe detyrat e forcave mbrojtëse të Kosovës. Procesi i RSSS hapi rrugën për zhvillime të rëndësishme në këtë drejtim, sidomos me rekomandimin për krijimin e FAK dhe përpilimin e dy dokumenteve bazë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK) dhe Strategjia Ushtarake (SK).

Bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë në fushën e koncepteve për mbrojtjen ka nisur në 2012 me vendosjen e lidhjeve midis institucioneve përkatëse, konkretisht komandave të doktrinave dhe stërvitjes (KDS) (për Shqipërinë, Qendra e Studimeve Strategjike e FASH, brenda KDS)<sup>56</sup>. Deri tani është përcaktuar “Hierarkia doktrinale” me Doktrinën e Përgjithshme si “gurin e kreut”, shtatë doktrina të tjera si “themelore”, të cilat ndiqen nga një numër i madh rregulloresh e manualesh. Dy doktrina janë përpiluar deri tani, Doktrina e Përgjithshme dhe Doktrina e Stërvitjes. Doktrina e Përgjithshme, për shkak të lidhjeve direkte që ka me SSK dhe SU (të cilat nuk janë përgatitur ende) dhe referimeve ndaj FAK dhe misioneve e detyrave klasike mbrojtëse të saj (të cilat për t’u implementuar kërkojnë amendimin e Kushtetutës) nuk ka hyrë ende në fuqi. Doktrina e Stërvitjes (pothuajse një adoptim i doktrinës përkatëse të FASH) është miratuar dhe ka nisur të zbatohet në trajnimin e FSK.<sup>57</sup>

53 Kodheli, Ministre e Mbrojtjes e RSH, intervistë: <http://revistajava.al/kryesore-ne-kopertine/20141124/pse-u-mbyllet-dosjet-e-korrupsionit-ne-ushtri>

54 [http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2015&mm=01&dd=16&nav\\_id=92890](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2015&mm=01&dd=16&nav_id=92890)

55 Intervista me persona të informuar nga Departamenti Planeve dhe Politikave (MFSK) si dhe me GJB Cikaqi e Kolonel Hadërgjonaj.

56 Intervista me persona të informuar nga ish-Qendra për Studime Strategjike (FASH) si dhe me GJB Cikaqi e Kolonel Hadërgjonaj.

57 Po aty.

Kur analizojmë ngrehinën konceptuale dhe proceset përkatëse në FSK, vlen të nënvizohen disa konstatime. Së pari, kushtet specifike në lidhje me çdo ndryshim kushtetues (përfshirë mbrojtjen) vështirësojnë edhe zhvillimet konceptuale e doktrimore. Duke qenë ky një proces “nga lart-poshtë”, është gati e pamundur të bësh përpara me përgatitjen e doktrinave sa kohë që përgatitja e SSK dhe SU ka ndalur<sup>58</sup>. Së dyti, objektivat e Fazës I të RSSS, “plotësimi i kuadrit kushtetues e ligjor, doktrinor e konceptual për forcën e re”, për shkak të ndërlikimeve kushtetuese, zor se mund të kryhet në periudhën e planifikuar 2014-2016<sup>59</sup>. Për rrjedhojë, do të duhen përpjekje të njëkohshme, për gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme kushtetuese e ligjore dhe paralelisht me to (për të fituar kohë) përgatitjen e kuadrit konceptual/doktrinor. Së treti, rekomandimet e RSSS për misionin e FAK të së ardhmes, përfaqësojnë një kërcim të madh nga misioni aktual humanitar i FSK, në misionet e garantimit të “integritetit territorial të vendit [...] dhe kalimit të përgjegjësive në fushën e emergjencave civile tek Ministria e Punëve të Brendshme”[MPB]<sup>60</sup>. Duke pasur parasysh “[...] një trend në rritje në çdo vend, që forcat ushtarake të kryejnë gjithnjë e më shumë misione të ndryshme nga ato tradicionale”<sup>61</sup>, kalimi i sipërpërmendur i përgjegjësive, nga FSK tek MPB zor se do të ndodhë. Për shkak të kapaciteteve unike, nivelit të lartë të gatishmërisë dhe aftësisë për t’u dislokuar në kohë të shkurtër, “forcat e armatosura po bëhen një nga institucionet e para tek të cilat politikëbërësit drejtohen kur përballen me sfidat e sigurisë të kohës së sotme”<sup>62</sup>. “[...] Angazhimi i ushtrisë në detyra të sigurisë civile po shihet si një [opsion] pa kosto e pa rrezik”<sup>63</sup>. Në këto kushte FSK/FAK duhet të jetë e përgatitur për t’u ngarkuar me misione të një spektri të gjerë, nga ato humanitare në mbrojtje klasike. Për rrjedhojë, kjo duhet të reflektohet që tani, në do-

kumentet përkatëse konceptuale/doktrimore. Së katërti, shfrytëzimi i përvojës dhe adopsioni i dokumenteve konceptuale/doktrimore të FASH mund të jetë një zgjidhje e volitshme për FSK/FAK<sup>64</sup>. Me gjithë ngërçin kushtetues/ligjor, disa doktrina më pak sensitive nga ana ligjore [si BCU<sup>65</sup>] mund të merren të gatshme nga FASH e përshtaten paraprakisht duke kursyer energji dhe kohë.

### 2.3. Menaxhimi i burimeve

Duke filluar nga viti 2011, FSK adoptoi të ashtuquajturin “Sistemi i Planifikim-Programim-Buxhetim-Ekzekutimit” [PPBES] në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes.<sup>66</sup> I krijuar e aplikuar në fillim të viteve 1960’ në SHBA, ky sistem u adoptua nga shumica e vendeve të ish Bllokut Komunist. Një nga meritat e PPBES është mundësia që ofron për të lidhur në një strukturë të vetme strategjitë ushtarake, programet dhe buxhetet, duke krijuar struktura të integruara menaxhimi ku buxheti buron nga programet, programet nga kapacitetet operacionale, të cilat, nga ana e tyre, përcaktohen si të nevojshme për të realizuar objektivat e SSK dhe SU. Me gjithë potencialet që ky sistem ka për të mbajtur nën kontroll të njëkohshëm e harmonizuar “autputet” [kapacitetet operacionale] me “inputet” [paratë] ai ka rezultuar joefektiv, bile një dështim, sa herë që “Buxheti” (me një horizont kohor 1-3 vjet, në duart e lidhshëm politik) i është imponuar “Planifikimit” dhe “Programimit” [i përgatitur nga profesionistët ushtarakë me shtrirje kohore afatmesme/afatlargët].

Bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë në drejtim të PPBES ka konsistuar në disa prezantime informuese/familjarizuese prej ekspertëve të FASH me lidhshëm të drejtuesit e departamenteve të MFSK dhe komandave kryesore të FSK, të kryera gjatë vitit 2012. Nga ana tjetër, që nga fundi i 2009, një ekspert i buxhetimit prej FASH, u atashua si këshill-

58 Për shkak të kushtit të sipërpërmendur të 2/3 të votave për ndryshimet kushtetuese

59 Raporti vjetor MFSK, 2014, p.26

60 Analiza e RSSS, f. 5

61 Clarke, “Per Concordiam”, 2015, f.11

62 Saleses, “Per Concordiam”, 2015, f.8.

63 Clarke, “Per Concordiam”, 2015, f.11

64 Në bazë të marrëveshjes midis MMRSH dhe MFSK “Për Arsimim – Stërvitjen”, 2014, Neni 4/8.

65 BCU – Bashkëpunimi Civil-Ushtarak

66 Intervista me persona të informuar nga Departamenti Planeve dhe Politikave [MFSK].



tar, pranë Drejtorisë së Buxhetit të MFSK. Pas vitit 2012 ky bashkëpunim u ndërpre pothuajse plotësisht.<sup>67</sup> MFSK filloi bashkëpunimin në këtë fushë me Institutin e Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes (SHBA) i cili mori përsipër organizimin e kurseve trajnuese në Kosovë dhe [për disa drejtues të lartë të MFSK] në SHBA.<sup>68</sup>

### 2.3.1. Planifikimi

Në kuadrin e PPBES, "Planifikimi" merret kryesisht me çështjet: "Ndaj cilave kërcënime duhet planifikuar"? "Çfarë kapacitetesh nevojiten"? "Çfarë investimesh [njerëzore, pajisje, infrastrukturë, trajnim] duhen bërë në sektorin e mbrojtjes për të përballuar sfidat e sigurisë"? "Si mund t'i mbajmë forcat e armatosura në balancën optimale midis efektivitetit dhe kostos"? Disa nga produktet e "Planifikimit" që adresojnë çështjet e mësipërme janë: Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK); Strategjia Ushtarake (SU); Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcës së Armatosur (PAZH); Planet mbështetëse të PAZH të tilla si: Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Plani Mbështetës Logjistike, Plani i Modernizimit, etj. Procesi i RSSS i realizuar në Kosovë midis Prillit 2012 dhe Marsit 2014, mund të konsiderohet gjithashtu si pjesë e "Planifikimit", për shkak të qëllimit, metodologjisë së aplikuar dhe paketës së dokumenteve strategjike që rekomandoi për t'u përgatitur për sektorin e mbrojtjes (SSK, SU, PAZH, Plani Menaxhimit të Personelit, Plani Mbështetës për Operacionet dhe Trajnimin, Plani i Komunikimit, Plani Mbështetës Logjistike dhe Plani i Mbështetjes Shëndetësore)<sup>69</sup>.

RSSS përkoi pjesërisht në kohë me procesin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM) të kryer në Shqipëri midis Shkurtit 2011 e Prillit 2013. Megjithatë termi "mbrojtje", formalisht, u theksua më shumë tek RSM në krahasim me RSSS, midis dy proceseve pati shumë anë

të përbashkëta në aspektin e institucioneve të angazhuara<sup>70</sup>, metodologjisë<sup>71</sup>, autoritetit koordinues<sup>72</sup>, etj. Pavarësisht nga kjo, bashkëpunimi midis dy proceseve ishte minimal. Më shumë ai konsistoi në dhënien e informacionit nga MMRSH tek MFSK në lidhje me tematikën e skenarëve dhe disa teknika për vlerësimin/përcaktimin e kapaciteteve operacionale për të menaxhuar secilin nga skenarët e planifikuar. Në mungesë të ndonjë arsyeje bindëse për këtë nivel bashkëpunimi, mund të supozohet që duke qenë se të dy proceset, në Shqipëri dhe në Kosovë, u asistuan nga Iniciativa Amerikane për Reformat e Institucioneve të Mbrojtjes (DIRI)<sup>73</sup> ndoshta u konsiderua i panevojshëm një bashkëpunim më i thellë midis vetë institucioneve të mbrojtjes të Shqipërisë dhe Kosovës. Sidoqoftë, në të ardhmen MMRSH mund të mbështesë MFSK në përgatitjen e dokumenteve të tjerë strategjikë, pas zgjidhjes së ngërçit kushtetues të sipërpërmendur. Objektivi i FASH për të rishikuar dokumentet e veta të SU dhe PAZH gjatë vitit 2015, mund të ndikojë pozitivisht në këtë proces.

### 2.3.2. Programimi

"Programimi" përbën një nga novacionet dhe pikat e forta të PPBES, me efekte rrënjësore në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes. Kjo i dedikohet produkteve të tij "programeve të mbrojtjes" dhe rolit si urë lidhëse midis "Planeve" [vizionit] dhe "Buxhetit" [burime-

70 Përveç MMRSH, në RSM të Shqipërisë u përfshinë edhe 6 institucione të tjera: Ministria e Jashtme, Brendshme, Financës, Transportit, Drejtësisë, dhe Shërbimi Informativ Shtetit.

71 Të dyja (RSSS dhe RSM) aplikuan metodologjinë "Planifikim mbi bazë kapacitetesh", sipas të cilës parashikohen skenarët më të mundshme ndaj sigurisë [përkatesisht 12 dhe 13 skenarë, të shtrira nga ato humanitare, në mbrojtje klasike e deri në kontribute jashtë vendit]. Gjithashtu, u parashikuan kapacitetet e nevojshme për menaxhimin e tyre si dhe burimet për krijimin e këtyre kapaciteteve [intervista me persona të informuar nga KDS e FSK dhe MMRSH].

72 Autoriteti koordinues - në Kosovë, Ministri i FSK, në Shqipëri, Zv.Ministri i Mbrojtjes.

73 DIRI si pjesë e Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, intervistë me person të informuar nga MMRSH, gjithashtu Welch, 2014, tek: <http://www.ssrresource-centre.org/2014/06/19/kosovos-home-grown-ssr-the-strategic-security-sector-review-part-two/>

67 Intervistë me Z. Dedgjonaj, ish-Zv.Drejtor për Programet, Shtabi Përgjithshëm FASH.

68 Po aty.

69 Raport Vjetor, MFSK, 2014, f. 27.

ve]. “Programet e mbrojtjes” fokusohen tek “*outputet*”, kapacitetet operacionale, krejt ndryshe nga “programet buxhetore”, të cilat nga vetë natyra fokusohen tek “*inputet*”, duke i kushtuar rëndësi vetëm fondeve të alokuara dhe shpenzimit ritmik të tyre. Përgatitja e “programeve të mbrojtjes” në një në mënyrë të tillë që të përmbushin rolin për të cilin janë destinuar është sfidë. Kapërcimi i saj kërkon një korpus të kualifikuar menaxherësh (që kërkon kohë dhe përpjekje). Gjithashtu është e domosdoshme që “Programimit” t’i jepet autoriteti i nevojshëm mbi “Buxhetimin”. Në fakt, në shumë raste, është “Buxhetimi”, i cili, i influencuar nga koniunktura politike/financiare e momentit, imponohet në mënyrën e shpenzimit të fondeve, pavarësisht nga ç’është programuar, gjë që praktikisht është “*të vendosësh karrocën përpara kalit*”.

Asistenca e FASH për FSK në fushën e “Programimit” do të kishte qenë me vlerë të jashtëzakonshme, por me përjashtim të disa leksioneve të sipërpërmendura, kjo asistencë ka munguar. Puna me programet e mbrojtjes merr një rëndësi të veçantë për FSK, sidomos për faktin që, bazuar në objektivat e RSSS, duke filluar nga viti 2017, do të fillojë prokurimi në masë i pajisjeve individuale dhe kolektive për FAK.<sup>74</sup> Në fakt, FASH e kanë të pamundur të japin këtë lloj asistence për FSK, për shkak se “Programimi” mbetet pika më e dobët në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes në Shqipëri. Ky konkluzion mund të nxirret mbështetur në një numër dokumentesh zyrtare, që përmbajnë raste ku janë shpenzuar para pa prodhuar kapacitete ose janë blerë pajisje që nuk janë përdorur kurrë.<sup>75</sup>

### 2.3.3. Buxhetimi

Procesi i buxhetimit ka rolin e vet të pazëvendësueshëm, pasi në mungesë të fondeve, çdo aktivitet dështon, ndërsa planifikim/programimi perkatës kthehet në diçka boshe. Nga ana tjetër, për shkak se buxhetimi

merret me “para reale”, në duart e drejtuesve politikë, ka prirjen t’u imponohet “Planifikimi” dhe “Programimi”, në vend të udhëhiqet prej tyre.

Analiza e buxhetimit në FSK zbulon se përveç faktit që buxhetet vjetore të miratuara janë më të vogla se planifikimi me 5.2% në 2013<sup>76</sup> dhe 3.6% në 2014<sup>77</sup> [gjë që në një shkallë më të vogël ndodh pothuajse në çdo organizatë] ekziston paaftësia për ta ekzekutuar plotësisht këtë buxhet. Kështu, ekzekutimi i buxhetit deri në fund të muajit nëntor ishte rreth 76% në 2012<sup>78</sup> [60% në investime] dhe 93% në 2014<sup>79</sup> [mungojnë detajet për realizimin e kategorive të ndryshme të buxhetit për këtë vit]. Një tjetër problem në aspektin e buxhetimit lidhet me raportet midis kategorive të ndryshme të tij, të cilat, të krahasuara me ushtritë e tjera, ndryshojnë dukshëm. Kështu, referuar raporteve vjetore të MFSK, 40% e buxhetit alokohet për personelin, 23% për shpenzimet operacionale/mirëmbajtje [O&M] dhe 36% për investimet.<sup>80</sup> Duke qenë se kategoria “investime” nuk është specifikuar ndarazi për pajisjet dhe infrastrukturën, nuk mund të gjykohet niveli i buxhetit për secilën nënkategori, por mund të supozohet që një pjesë e konsiderueshme shkon ende për infrastrukturën. Referuar dokumenteve të NATO-s, vendet anëtare të saj, mesatarisht alokojnë 50-55% të buxhetit të mbrojtjes për “Personelin”, rreth 30% për “O&M”, rreth 15-20% për “Pajisjet” dhe më pak se 2% për “Infrastrukturën”.<sup>81</sup> Në diskutimet me personel të informuar të FSK në kuadrin e këtij studimi, u pretendua që mospërputhjet e mësipërme janë rezultat i kategorizimit të ndryshëm që bëhet aktualisht në buxhetimin e FSK, gjë që, sipas tyre, do të sillte gradualisht në linjë me metodologjinë e NATO-s.

Një tjetër konkluzion që mund të tërhiqet pas konstatimit të mosrealizimeve në buxhet,

74 Raport Vjetor, MFSK, 2014, f.26

75 Kodheli, Ministre e Mbrojtjes, bisedë, Universiteti “Luarasi”, Gazeta “Ushtria”, 21 Nëntor 2014.

76 Raport Vjetor, MFSK, 2013, f.10

77 Raport Vjetor, MFSK, 2014, f.7

78 Raport Vjetor, MFSK, 2012, f.9.

79 Raport Vjetor, MFSK, 2014, f.7

80 Po aty

81 NATO, “Financial and economic data relating to defense”, 2014, f.8-9.

sidomos në kategorinë “Investime”, është prirja e buxhetuesve për të shkurtuar para [për arsye ekonomike/politike] atje ku kjo është më e lehtë për ta, pa u kujdesur për pasojat operationale. Më shpesh kjo ndodh me “investimet” dhe “O&M” [sidomos me trajnimet]. Kapacitetet operationale përbëhen nga porcione të caktuara të kategorive “personel”, “O&M”, “pajisje” dhe “infrastrukturë”. Është e kuptueshme që reduktimi i fondeve nga buxhetuesit, “qorrazi”, pa u kujdesur për këto porcione, i “deformon” kapacitetet operationale, duke i bërë ato joefektive. Në këtë aspekt, Shqipëria mund të bëhej një partner i rëndësishëm për bashkëpunim. Kjo u njoh edhe nga NATO, e cila, nëpërmjet grupit të saj këshillues [NAT] të atashuar pranë FSK, propozoi që ekspertiza për FSK në këtë fushë të jepej nga Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë. Për këtë, sikurse u përmend më lart, një ekspert i fushës nga FASH u caktua për të punuar e asistuar Drejtorinë e Buxhetit të FSK. Pas një bashkëpunimi të suksesshëm për mbi 2 vjet [2009-2012] të njohur e vlerësuar edhe nga MFSK dhe NAT, një tjetër person u dërgua si zëvendësues, pa eksperiencë në këtë fushë, gjë që solli ndërprerjen e kësaj asistence nga FASH duke ia besuar një ushtrie tjetër.

## 2.4. Arsimimi dhe stërvitja

Bashkëpunimi në fushën e Arsimim-Stërvitjes [A&S] konsiderohet si më i pranueshmi, bile edhe në kontekste marrëdhëniesh sensitive. Në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak Shqipëri-Kosovë, në kushtet e sensibiliteteve të përmendura më lart për nismat e Shqipërisë ndaj Kosovës, bashkëpunimi në A&S midis FASH e FSK ka qenë më i preferueshëm nga çdo aspekt. Një tjetër faktor mbështetës për këtë është gjuha. Ndërsa në ofertat e vendeve të tjera për A&S, gjuha [zakonisht anglishtja] ka qenë një barrierë serioze, kurset e ofruara prej Shqipërisë [me përjashtim të Kursit të Lartë të Sigurisë] zhvillohen në gjuhën shqipe, që përbën një lehtësi të madhe për studentët e dërguar nga FSK. Marrëveshja “Mbi bashkëpunimin në fushën e arsimimit ushtarak dhe trajnimit”, nënshkruar

midis Shqipërisë dhe Kosovës në 2014<sup>82</sup>, përfshin unifikimin e strukturave dhe programeve të A&S, rezervimin e deri 10% të kuotave të kurseve në Shqipëri për anëtarët e FSK, stërvitje të përbashkëta para-dislokim për misionet jashtë vendit, etj<sup>83</sup>.

Nga pikëpamja strukturore, tashmë ka një ngjashmëri të madhe midis institucioneve ushtarake të A&S në Shqipëri dhe në Kosovë. Në të dy vendet është Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes [KDS] që ka përgjegjësinë për A&S. Ngjashmëri në misionet, detyra e struktura ekzistojnë gjithashtu edhe midis institucioneve vartëse brenda KDS-ve.<sup>84</sup> Një numër i konsiderueshëm programesh stërvitore të KDS të FSK janë marrë direkt nga KDS e FASH me disa ndryshime të vogla, për t'i sjellë ato plotësisht në përputhje me misionin e FSK [që aktualisht nuk përfshin misionet klasike luftarake].<sup>85</sup>

MMRSH ka ofruar mbështetje për trajnimin e pjesëtarëve të FSK për nivelet: Oficer Shtabi [kapiten]; Shtab i Përgjithshëm [major]; Kursi i Lartë i Oficerit [nënkolonel] dhe Kursi i Lartë i Sigurisë. Deri tani, referuar të dhënave, me përjashtim të viteve 2010 e 2012, kur pjesëmarrja nga FSK ka qenë përkatësisht 23 dhe 9 oficerë, në vitet e tjera akademike, duke filluar që nga viti 2002, kjo pjesëmarrje ka qenë midis zero dhe dy. Në total, për të gjithë periudhën 2002-2014, janë 46 oficerë nga Kosova që kanë ndjekur kurse të ndryshme ushtarake në Shqipëri, me një mesatare prej 3.5 studentë/vit që është më e ulët se kontributi i disa vendeve të tjera ndaj FSK në këtë fushë [Turqia – 9 studentë/vit; Maqedonia – 5; ShBA – 4; Kroacia – 2.5, etj]<sup>86</sup>. Ka disa arsye për këta tregues. Aktualisht ofertat ndaj FSK për trajnime janë bërë nga disa vende, në sasi që i tejkalojnë mundësitë e FSK për

82 <http://www.ata.gov.al/shqiperi-kosove-protokolle-bashkepunimi-ne-fushen-e-mbrojtjes-144442.html>

83 Neni 4 i Marrëveshjes.

84 KDS e FSK konsiston në 5 qendra [për studime universitare; stërvitje bazë; stërvitje speciale; stërvitje e sh-tabeve; stërvitje kolektive] dhe një sektor për zhvillimin e doktrinave. Kjo strukturë është shumë e ngjashme me KDS të FASH, përjashtuar studimet universitare.

85 Intervistë me GJB Cikaqi dhe Kolonel Hadërgjonaj.

86 Raportet Vjetore, MFSK, 2013 [f.29] dhe 2014 [f.23].

t'iu përgjigjur<sup>87</sup>. Nga ana tjetër, Shqipëria ka ofruar trajnime për grada nga “Kapiten” në “Kolonel”, të cilat FSK i ka ende në numër të kufizuar (një organizatë e re, me 6 vjet ekzistencë).

Një nga nevojat më imediate të FSK është përgatitja e oficerëve të rinj. Aktualisht, arsimimi i kësaj kategorie kryhet në Kosovë, në Qendrën e Studimeve Universitare<sup>88</sup> dhe në disa vende të tjera si ShBA, Turqi, Maqedoni<sup>89</sup>. Duke filluar nga viti 2008, Shqipëria i ka mbyllur institucionet e veta ushtarake për këtë nivel arsimimi. Pas një hezitimi disa vjeçar në lidhje me opsionin më të leverdishëm, pasi çështja e futjes së “gjakut të ri” u bë mjaft urgjente për vetë FASH, zgjidhja u gjet vetëm në 2014, nëpërmjet përgatitjes së tyre në ShBA, si një bashkëpunim dypalësh me Gardën Kombëtare të New Jerseyt.

Duke filluar nga viti 2012, FSK ka vendosur një traditë të mirë stërvitjesh (qofshin ato me trupa, me komanda e shtabe apo stërvitje simulimi). Ato janë kryer në vend (rreth 5-6 stërvitje në vit, me gati çdo njësi kryesore) ose jashtë vendit.<sup>90</sup> Stërvitjet shumëkombëshe ku FSK ka marrë pjesë janë me rëndësi të jashtëzakonshme për personelin dhe shtabet e angazhuara, për shkak të përvojës që ato fitojnë në vendimmarrje dhe menaxhimin e skenarëve të ndryshëm. Në këtë kontekst, FSK dhe FASH kanë bashkëpunuar në dy stërvitje në vitet 2013<sup>91</sup> e 2014. Megjithatë, mungesa në Shqipëri e poligoneve që plotësojnë standardet për stërvitje me trupa për

skenarë të ndryshëm ka bërë që ky bashkëpunim të mbetet i kufizuar.<sup>92</sup>

## 2.5. Operacionet

Operacionet, aftësia për zhvillimin e suksesshëm të tyre, është në fakt qëllimi përse forcat e armatosura ekzistojnë. Sikurse është përmendur, FSK është përgjegjëse kryesisht për menaxhim krizash, shkatërrimin e eksplozivave dhe mbrojtjen civile.<sup>93</sup> Arritja e “Kapacitetit të Plotë Operacional” dhe njohja e kësaj nga NATO, në Korrik 2013<sup>94</sup>, përfaqëson një gur të rëndësishëm kilometrik në procesin e profesionalizimit të saj. Ndërsa mundësia që FASH e FSK të angazhohen në një operacion konvencional e bashkëpunojnë për mbrojtjen e territoreve të veta, duket e pakët (si rezultat i situatës gjeo-strategjike relativisht paqësore në rajon) mundësitë për bashkëpunim midis tyre në aspekte të tjera të mbrojtjes civile janë të mëdha. Për shkak të një numri gjeo-faktorësh, Shqipëria dhe Kosova kërcënohen nga rreziqe natyrore të përbashkëta si përmytje, zjarre masive, tërmete, etj. Duke qenë se këto fatkeqësi nuk njohin kufij politikë, një bashkëpunim i tillë është me përfitime reciproke. Bashkëpunimi për emergjencat civile mund të zhvillohet në disa drejtime si: trajnime të përbashkëta, shkëmbim informacioni dhe përvoja e deri tek bashkimi i kapaciteteve/burimeve që do t'i bënte ato më efektive e me kursime të mëdha kostosh për secilin nga vendet. Midis faktorëve që favorizojnë bashkëpunimin në këtë fushë, është akti që si FASH ashtu dhe FSK kanë një rol të spikatur në menaxhimin e emergjencave civile, ndryshe nga ushtritë në shumë vende të tjera. Në Kosovë, megjithëse nga aspekti ligjor FSK ka një “rol mbështetës” në rast emergjencash civile, në fakt “ka luajtur një rol primar dhe ka qenë reagues i parë”<sup>95</sup>. E njëjta situatë ekziston edhe në Shqipëri. Deri tani, sikurse u përmend më lart, trupat e FSK kanë marrë pjesë në tre op-

87 Në vitin 2011 e 2012, FSK mori pjesë, respektivisht në 51 dhe 80 lloje trajnimesh me përkatësisht 11 e 20 vende (përfshi Shqipërinë, ShBA, Anglinë, Lituaninë, Turqinë, Estoninë, Gjermaninë, Holandën, Japoninë, Slloveninë, Hungarinë, etj) – Raportet Vjetore, MFSK 2011 e 2012 dhe intervistë me GjB. Cikaqi.

88 Çdo vit, në Kosovë, diplomohen nga Qendra e Studimeve Universitare 12-16 oficerë të rinj (Universitet 4-vjeçar, dy diploma) me një kosto 4-vjeçare për person prej 4,000 Euro (përballohet nga buxheti i FSK) – intervistë me GjB Cikaqi dhe Kolonel Hadërgjonaj.

89 Raportet vjetore, MFSK, 2011 - 2014.

90 Për më shumë informacion për stërvitjet shih raportet vjetore të MFSK, vitet; 2012, 2013, 2014.

91 Në 2013, 39 ushtarakë të FSK morën pjesë në një stërvitje në Shqipëri [Raport Vjetor, MFSK, 2013, f.29].

92 Intervista me persona të informuar nga FSK dhe FASH.

93 Plani Ahtisaari, 2007, Aneks 8, Neni 5.4

94 Raport Vjetor, MFSK, 2013, f.5.

95 Analiza e RSSS, 2014, f.29.

eracione të emergjencave civile në Shqipëri [kontributi më madh i tyre në Janar 2010].

Një nga “Objektivat Strategjike” të MFSK për vitin 2015 është planifikimi dhe fillimi dërgimit të trupave në operacione jashtë vendit të drejuara nga NATO.<sup>96</sup> Në angazhime të tilla, një nga masat paraprake më kryesore është stërvitja para-dislokim. Në këtë aspekt, FASH kanë fituar një përvojë të çmuar në sajë të pjesëmarrjes të deritanishme në misione jashtë vendit<sup>97</sup>, përvojë e cila bashkë me infrastrukurën stërvitore të saj, mund të jetë e dobishme edhe për FSK, në angazhime të tilla. Disa nga stërvitjet komando-shtabi dhe me trupa, të përmendura më lart, midis FASH dhe FSK i kanë shërbyer edhe këtij qëllimi dhe duhet të vijojnë edhe në të ardhmen.

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rrënjët e përbashkëta etnike të shqiptarëve në Shqipëri e Kosovë, si dhe angazhimi i qeverive përkatëse për bashkëpunim, janë një bazë e fuqishme për të rritur bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve, në të mirë të sigurisë së tyre por edhe të rajonit.

Pavarësisht faktorëve favorizues, deri tani, bashkëpunimi ushtarak midis Shqipërisë dhe Kosovës nuk ka mundur të shfrytëzojë të gjitha potencialet e veta. Tre faktorë duket se kanë penguar për një bashkëpunim më të frytshëm midis dy vendeve: a) ndjeshmëria deri shqetësimi [i nënkuptuar apo shprehur hapur] i komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, krahas disa vendeve të rajonit ndaj çdo iniciative të Shqipërisë në këtë drejtim; b) fakti që një numër i konsiderueshëm vendesh të tjera po ofrojnë asistencën e tyre ushtarake për FSK, asistencë që e tejkalon nga ana sasiore dhe cilësore atë që mund të ofrojë Shqipëria; c) për shkak të vështirësive të veta,

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë, në disa raste, ka dështuar në sigurimin e ekspertizës më të mirë për FSK.

Shqipëria dhe Kosova duhet të gjejnë mënyrat për të bashkëpunuar në të gjithë spektrin e aktiviteteve të mbrojtjes, por fokusi duhet të jetë në fushat ku ky bashkëpunim është më efektiv, veçanërisht në fushën e koncepteve dhe doktrinave, arsimim-trajnimin ushtarak, integritet Euro-Atlantik, operacioneve, etj.

Ndërsa kufizimet kushtetuese për zhvillimin e një sektori real mbrojtjeje në Kosovë kërkojnë zgjidhje politike e ligjore, puna paraprake për zhvillimin e koncepteve dhe doktrinave, e nisur tashmë, duhet të çohet më tej, nëpërmjet përgatitjes së drafteve, për të mundësuar miratimin e tyre menjëherë pasi amendimet kushtetuese ta lejojnë këtë. Në këtë aspekt, një numër dokumentesh të kësaj natyre, mund të merren direkt nga FASH me disa përshtatje të vogla, për të kursyer kohë dhe përpjekje.

Menaxhimi i burimeve të mbrojtjes është një nga fushat ku asistencë e dhënë ndaj një organizate të re si FSK/FAK do të ishte nga më të vlerësuarat dhe me efekte afatgjata. Për fat të keq, implementimi i sistemit të Planifikim – Programim – Buxhetim - Ekzekutimit në FASH po ecën më vështirësi. Për këtë arsye, me gjithë rëndësinë që do të kishte për FSK asistencë në këtë fushë, vetë FASH mund të japin një ndihmë modeste, kryesisht në komponentin “Planifikim”.

Ndërsa bashkëpunimi në fushat e mësipërme është i natyrës “formuese”, bashkëpunimi në fushën e operacioneve është me përfitim të dyfishtë. Duke menaxhuar situata konkrete [humanitare, konvencionale, rreziqe asimetrike] çdo operacion i ndërmarrë, përmirëson gjithashtu strukturën dhe performancën e forcës së armatosur. Bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë në fushën e operacioneve është me përfitime reciproke dhe duhet thelluar. Stërvitjet e përbashkëta, bazuar në skenarë të parashikuar drejt, janë mënyra më e mirë për të përmirësuar ndërveprueshmërinë midis tyre. Nga ana tjetër, ky lloj bashkë-

<sup>96</sup> Raport Vjetor, 2014, f.28

<sup>97</sup> Kontributi i FASH në misione jashtë vendit, filloi me një kompani, në 1996, në BiH, dhe u rrit ndjeshëm në rreth 430 midis 2008 e 2010. Shih tek: <http://www.aaf.mil.al/english/index.php/misione-aktuale> dhe <http://www.aaf.mil.al/english/index.php/misione-te-kryera>

punimi ka efekte pozitive edhe në opinionin publik të të dy vendeve.

Së fundi, vlen të mbahet parasysh se bashkëpunimi Shqipëri-Kosovë në fushën e mbrojtjes nuk duhet parë si “udhë një-kalimëshe”. Çdo asistencë dhënë institucioneve mbrojtëse të Kosovës, ka pa dyshim efektet e veta pozitive edhe ndaj vetë shtabeve dhe njësive të FASH të përfshira në këtë proces.

## BIBLIOGRAFI

### Raporte dhe artikuj

- Analiza Strategjike e Sektorit të Sigurisë në Republikën e Kosovës [Anglisht] Prishtinë, 2014, tek: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analysis\\_of\\_Strategic\\_Security\\_Sector\\_Review\\_of\\_RKS\\_060314.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analysis_of_Strategic_Security_Sector_Review_of_RKS_060314.pdf)
- Geci Sinan "Kosovo Security Force, Post 2012", 2011, at: [https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13687/SinanGeci\\_CapstoneProject\\_Report\\_5-07-2011.pdf?sequence=6](https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13687/SinanGeci_CapstoneProject_Report_5-07-2011.pdf?sequence=6)
- Goxhaj Dilaver, "Drama e UÇK dhe Adem Demaçit, Edlora, Tiranë, 2014.
- Kosovo Security Barometer, Special Edition, December 2013, at: [http://www.qkss.org/repository/docs/RSB\\_708405.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/RSB_708405.pdf)
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, tek: <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>
- MFSK, Raport Vjetor [Anglisht] 2011, tek: [http://www.mksf-ks.org/repository/docs/raporti\\_anglisht\\_final.pdf](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/raporti_anglisht_final.pdf)
- MFSK, Raport Vjetor [Anglisht] 2012, tek: [http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Raporti\\_i\\_MFSK\\_2012\\_-\\_MKSF](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Raporti_i_MFSK_2012_-_MKSF), Annual Report, 2013, at: [\\_Reviste\\_-\\_anglisht\\_i\\_botuar.pdf](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Reviste_-_anglisht_i_botuar.pdf)
- MFSK, Raport Vjetor [Anglisht] 2013, tek: [http://www.mksf-ks.org/repository/docs/RAPORTI\\_VJETOR\\_\\_2013\\_\\_i\\_publicuar\\_\\_anglisht.pdf](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/RAPORTI_VJETOR__2013__i_publicuar__anglisht.pdf)
- MFSK, Raport Vjetor [Anglisht] 2014, tek: [http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Annual\\_Report\\_of\\_MKSF\\_for\\_2014\\_\\_english2.pdf](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Annual_Report_of_MKSF_for_2014__english2.pdf)
- Muja Armend, "What next for the KSF, an army or not?" 2013, at: [http://216.67.253.126/repository/docs/What\\_next\\_for\\_KSF\\_An\\_Army\\_or\\_not\\_843256.pdf](http://216.67.253.126/repository/docs/What_next_for_KSF_An_Army_or_not_843256.pdf)
- NATO, Financial and Economic Data Relating to Defense, 2014, at: [http://www.nato.int/nato\\_static\\_fl2014/assets/pdf/pdf\\_topics/20140224\\_140224-PR2014-028-Defence-exp.pdf](http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_topics/20140224_140224-PR2014-028-Defence-exp.pdf)
- Per Concordiam, Volume 6, Issue 1, G.C. Marshall European Centre for Security Studies, 2015.
- Petersen S.J and Server D. "The Balkans Can Still Be Lost", 2010, at: [http://www.nytimes.com/2010/11/11/opinion/11iht-edjessen.html?\\_r=2](http://www.nytimes.com/2010/11/11/opinion/11iht-edjessen.html?_r=2)
- Pettiffer J and Vickers M, "The Albanian question", I.B.Tauris&Co Ltd, London, 2009.
- Plator Avdiu, "Kosovo's alternatives towards NATO Membership", 2015, at: [http://www.qkss.org/repository/docs/Destination\\_NATO\\_Kosovos\\_Alternatives\\_towards\\_NATO\\_Membership\\_556716.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Destination_NATO_Kosovos_Alternatives_towards_NATO_Membership_556716.pdf)
- Polovina Ylli, "Një kolonel midis Tiranës dhe Prishtinës", EMAL, Tiranë, 2007.
- Qehaja Florian, "The Development Context of the Strategic Security Sector Review", 2013, at: [http://216.67.253.126/repository/docs/The\\_Development\\_Context\\_of\\_Strategic\\_Security\\_Sector\\_Review\\_877377.pdf](http://216.67.253.126/repository/docs/The_Development_Context_of_Strategic_Security_Sector_Review_877377.pdf)
- Qehaja Ramadan, "Të bësh një karrierë ushtarake", Prishtinë, 2012.
- UN Secretary General, "Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement", [Ahtisaari Plan ] 2007, at: [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf)
- United Nations, "Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement", at: <http://www.unosek.org/docref/report-english.pdf>
- Vickers Miranda, "The role of Albania in the Balkan region", *Chaillot Paper, No107, Jan.2008*, at: <http://www.iss.europa.eu/uploads/media/cp107.pdf>
- Vrajolli Mentor dhe Kallaba Pëllumb, "Kosovo path towards the NATO PfP Program", 2012, at: [http://216.67.253.126/repository/docs/Kosovo%27s\\_Path\\_towards\\_the\\_NATO\\_Partnership\\_for\\_Peace\\_Programme\\_839019.PDF](http://216.67.253.126/repository/docs/Kosovo%27s_Path_towards_the_NATO_Partnership_for_Peace_Programme_839019.PDF)
- Wickers Miranda, "Between Serb and Albanian, a history of Kosovo", Columbia University Press, New York, 1998.
- Winkler Theodor, "The reform and democratic control of the security sector and international order", DCAF, 2002.

### Intervistat:

- **Cikaqi Enver**, Gjeneralbrigade, Komandant i KDS të FSK
- **Dedgjonaj Kolë**, Nënkolonel (në pension), ish-Zv.Drejtor, Drejtoria e Programimit, Shtabi Përgjithshëm FSH, ish pjesëtar i NAT atashuar në Drejtorinë e Buxhetit të MFSK.
- **Dugolli Enver**, Nënkolonel, Atashe Usharak i Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë.
- **Geci Faruk**, Drejtor, Drejtoria për Plane e Politika, MFSK.
- **Geci Sinan**, Shef Sektori, Departamenti për Siguri e Bashkëpunim, MFSK.
- **Goxhaj Dilaver**, Kolonel (në pension) ish-Pedagog e Shef Katedre, Akademia e Mbrojtjes e FASH, ish-Zv.Shef i Shtabit Përgjithshëm të UÇK, ish-Shef i Kabinetit të Ministrit të Mbrojtjes të Kosovës.
- **Hadërgjonaj Fadil**, Kolonel, Shef i Shtabit të KDS FSK.
- **Hisen Berisha**, Oficer Shtabi, Sektori për Strategji dhe Doktrina, MFSK.
- **Hoxha Fiqiri**, Kolonel, Atashe i Ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës.
- **Koliqi Shaqir**, Nënkolonel (në pension), ish-anëtar i NAT, atashuar tek Departamenti Zbulimit i FSK.
- **Qehaja Ramadan**, Gjeneralmajor (në pension), ish-Komandant i Akademisë së Trupave Mbrojtëse të Kosovës.
- **Qeriqi Ilir**, Kolonel, Drejtor i Departamentit të Sigurisë dhe Bashkëpunimit, MFSK.



## PËR AUTORIN

**Kolonel** [në rezervë] **Dr. Foto Duro** i është bashkuar Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FASH) në vitin 1981. Arsimin ushtarak e ka kryer në Shqipëri dhe jashtë saj [në SHBA, Gjermani, Britani të Madhe dhe Zvicër]. Gjatë më shumë se 30 viteve të karrierës së tij ushtarake Z. Duro ka shërbyer në detyra të ndryshme, ku, midis të tjerash, ka luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe përgatitjen një numri dokumentesh strategjike për FASH. Aktualisht ai punon në Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim në Tiranë, ku është i përfshirë në disa projekte të fokusuara në demokratizimin dhe europianizimin e sektorit të sigurisë në Shqipëri.

## PËR ORGANIZATAT

### QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) Kosovë

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2008 me qëllim kryesor të zhvillojë studimet kërkimore-shkencore, në sektorin e sigurisë. QKSS zhvillon hulumtime dhe organizon konferenca dhe seminare në fushën e politikave të sigurisë, sundimit të ligjit, drejtësisë, dhe monitorimin e sektorit të sigurisë. Aktivitetet e QKSS-së kontribuojnë në forcimin e parimeve të mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

### INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM (IDM) Shqipëri

IDM është një organizatë e pavarur jo qeveritare, themeluar në nëntor 1999 në Tiranë, Shqipëri. Ajo punon për të forcuar shoqërinë civile në Shqipëri, për monitorimin, analizimin dhe lehtësimin e proceseve Euro-Atlantike të vendit si dhe për të ndihmuar konsolidimin e qeverisjes së mirë dhe të politikëbërjes gjithëpërfshirëse në vend. IDM-ja ndërmerr objektivat e saj me anë të ekspertizës, studimeve inovative mbi politikën, analizat dhe opsionet politike që bazohen në veprim.

## RRETH PROJEKTIT

Forumi Hulumtues i Sigurisë është një projekt i përbashkët në mes të tri qendrave të pavarura hulumtuese nga Beogradi (BCSP), Prishtina (QKSS) dhe Tirana (IDM) të specializuara në hulumtimin e çështjeve të sigurisë. Projekti ka për qëllim të nxisë debat të balancuar midis qendrave hulumtuese (think-tank), komunitetit akademik, politikës publike dhe medias, në mënyrë që të sigurojë zgjidhje alternative për sfidat e vazhdueshme të bashkëpunimit ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Shqipërisë.

ISBN 978-9951-679-26-8



9 789951 679268



